

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2435/20 Prot.

Durrës, më 24.10.2025

VENDIM

Nr. 132, datë 24.10.2025

PËR

"DHËNIEN E TITULLIT "PROFESOR EMERITUS" PROF.DR. AFRIM HOTI"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", kreu V, pika 2; të Statutit të UAMD; të Rregullores së UAMD neni 109, pika 13; të shkresës Nr. 1105/9 Prot., datë 06.10.2025 të Rektorit "Ridërgohet kërkesa mbi dhënie të titullit "Profesor Emeritus", për Prof.Dr. Afrim Hoti", si dhe të shkresës së MAS Nr. 2818/4 prot., datë 17.10.2025, administruar pranë UAMD me Nr. 1105/10 prot, datë 21.10.2025, në mbledhjen e datës 24.10.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Dhënie të titullit "Profesor Emeritus" për Prof. Dr. Afrim Hoti, nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, me motivacion:
"Profesor Afrim Hoti ka shërbyer duke dhënë kontributin e tij në pozicione të ndryshme drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Ka qenë bashkëpunëtor i Akademisë së Shkencave në Tiranë. Ai ka spikatur në aktivitetin e tij Kërkimor - Shkencor, duke dhënë kontribut si pjesëmarrës, autor apo bashkautor në 25 Konferenca Ndërkombëtare. Gjithashtu ai ka qenë bashkautor në projekte të përbashkëta me studiues dhe arkeologë të universiteteve të Cincinatit (USA), Cambridge (Angli) e Parmës, Chietit në Itali. Autor i mbi 50 artikujve e punime studimore në revista shkencore dhe akte kongresesh e konferencash shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Bashkëdrejtues në projektin "Kërkime arkeologjike në Durrës" në bashkëpunim me Packard (instituti i Shkencave Humane ,2000)".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtoria e Projekteve dhe Mardhënieve me Jashtë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

